



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

---



**STATUT**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
BT SOLUTIONS SH.P.K**

---

**BT SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: + 355 42 374292  
Cel: + 355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

 **KYOCERA**  
Document Solutions

## **KAPITULLI 1**

### **KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI DHE SELIA**

#### **NENI 1**

#### **KRIJIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria BT SOLUTIONS sh.p.k është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si ''Shoqëria'') me vendim nr. 31808 datë 15.06.2004 të Gjykatës Tiranë, bazuar në ligjin nr. 7638 datë 19.11.1992 ''Për shoqëritë tregtare.''

Sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 ''Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare'', neni 230 ''Vijimi i funksionimit dhe detyrimi për përshtatje'' për shoqëritë të cilat janë krijuar në bazë të ligjit nr. 2638 datë 19.11.1992 ''Për shoqëritë tregtare'', janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas dispozitave të këtij ligji brenda 3-viteve pas hyrjes së tij në fuqi.

Mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 ''Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare'', hartuam këtë status të ri të ndryshuar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin ''BT SOLUTIONS'' Sh.p.k.

Shoqëria është person juridik shqiptar e përshtatur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 ''Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare''.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

#### **NENI 2**

#### **FORMA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që ortakët e kësaj shoqërie nuk do të marrin një vendim për shëndërrimin e saj në një shoqëri anonime.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 ''Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.''

#### **NENI 3**

#### **EMËRTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është ''BT SOLUTIONS'' sh.p.k.

---

BT SOLUTIONS  
Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: + 355 42 374292  
Cel: + 355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët: "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet sh.p.k.

#### **NENI 4**

##### **SELIA**

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën; Rruga Hoxha Tahsim, Nr. 62/5. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të kësaj shoqërie.

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al) dhe numri i kontaktit +35542374292.

#### **NENI 5**

##### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, por jo më pak se 20 vjet duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në QKR, Tiranë.

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

#### **NENI 6**

##### **OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "BT SOLUTIONS" sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

#### **1. Në fushën e tregëtisë shoqëria do të kryejë:**

Tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshëm si industriale, teknologjike, makinerish, pajisje dhe sisteme të informacionit, komunikimit dhe teknologjisë, elektrike dhe elektronike, mekanike, energjitike, sistemeve kondicionimi të të gjitha llojeve, pajisje mjekësore të të gjitha llojeve, izotope radiaktive që shërbejnë për terapi dhe diagnostikim sëmundjesh në përdorim të pajisjeve elektromjekësore. Projektimin, konsulencën, programimin, krijimin, zhvillimin, implementimin, përshtatjen dhe lokalizimin, sipërmarrjen zbatuese, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e programeve, aplikacioneve, dhe sistemeve software web-based, on-premise,

BT SOLUTIONS

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



cloud dhe hybrid. Instalimin, konfigurimin, sipërmarrjen zbatuese dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave dhe sistemeve hardware dhe software të teknologjisë së informacionit. Në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të infrastrukturës dhe /ose të pjesëve përbërëse të saj, për transportimin publik dhe /ose privat të njerëzve dhe mallrave brenda dhe jashtë territorit të vendit si dhe tranzitimin e tyre përgjatë territorit të Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj.

**2. Në fushën e mjedisit shoqëria do të kryejë:**

Projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kënetave si dhe çdo veprimtari që ka rëndësi për shoqërinë.

**3. Në fushën e prodhimit shoqëria do të kryejë:**

Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin e prodhimit me fonde publike dhe/ ose jopublike të materialeve të ndërtimit, prodhimin e inerteve, të asfalto-betonit, betonit, prodhimet e konstruksioneve metalike, beton armeje, plastike, të drurit dhe kombinime të ndryshme të tyre, prodhimin e bojrave dhe llaqeve të ndryshëm, të ambalazheve, çdo operacion industrial prodhues; prodhimin e motorrave dhe transformatorëve elektrike, transformatorët e tensionit të lartë, furrave elektrike, reaktorëve të çdo tipi dhe të gjitha paisjeve elektrike, studime dhe projekte për paisje dhe makineri elektrike; Prodhimin, projektimin, programimin, krijimin, zhvillimin, implementimin, përshtatjen dhe lokalizimin, sipërmarrjen zbatuese dhe konfigurimin e programeve, aplikacioneve, dhe sistemeve software web-based, on-premise, cloud dhe hybrid.

**4. Në fushën e shërbimeve shoqëria do të kryejë:**

Aktivitet në fushën e shërbimeve si përfaqësuese produktesh dhe kompanish të huaja dhe të vendit, carterime, brokerime, spedicione, transporti etj. Ofrim shërbimesh hardware dhe software në sektorin e teknologjisë dhe të informacionit, telekomunikacionit, shërbimeve me vlerë të shtuar, elektronikës dhe energjisë e pajisjeve të tjera që janë të lidhura me to,

**BT SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

 **KYOCERA**  
Document Solutions

pajisjeve mjekësore të të gjitha llojeve etj. Montim dhe mirëmbajtje të pajisjeve elektronike, të fushës kompjuterike, automatike industrial, mjekësore, sistemeve kondicionimi; Prodhim, projektim, programim, krijim, zhvillim, implementim, përshtatje dhe lokalizim, sipërmarrje zbatuese, konfigurim, mirëmbajtje dhe trajnim për programe aplikacione, dhe sisteme software web-based, on-premise, cloud dhe hybrid. Shërbim printimi, skanimi dhe fotokopjimi. Shitje tonërash me shumicë dhe pakicë. Implementim projektesh, pajisjesh elektronike dhe elektrike. Integrim sistemesh. Instalim dhe mirëmbajtje pajisjesh dhe sistemesh mjekësore. Dizënim, instalim infrastrukture IT. Zhvillim dhe tregtim i Software.

## **KAPITULLI 2**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

#### **NENI 7**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali është fiksuar në lek 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali përbëhet nga 1 kuotë me vlerë 10.000 Lek dhe numrin e fundit të shlyer në masën 100% nga ortakët themelues në raporte me zotërimin e kapitalit themeltar. Ai mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

#### **NENI 7/1**

#### **KUOTAT**

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të:

1. Kristi BOJDANI, zotëron 1 kuotë, me vlerë 100.000, numri i pjesëve 1 dhe përqindja e pjesëmarrjes 100.0%

#### **NENI 8**

#### **MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen ose kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë

---

**BT SOLUTIONS**  
Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: + 355 42 374292  
Cel: + 355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

**KYOCERA**  
Document Solutions

- Shitblerjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Cdo mënyre tjetër e parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

#### **NENI 9**

#### **PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESËTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE**

Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre.

Nëse njëri prej ortakëve (ortaku shitës) ka si qëllim t'i transferoj të tretëve, tërësisht apo pjesërisht kuotat e shoqërisë në pronësi të tij (në vijim kuotat e ofruara duhet që paraprikisht, sipas të drejtës së parablerjes t'ia ofroj këto kuota ortakëve të tjerë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim i cili duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat e blerësit, numrin e kuotave që ka si qëllim të shesë, çmimin e shitjes dhe çdo afat apo kusht tjetër për transferimin.

Nëse ortakët e tjerë kanë si qëllim të ushtrojnë të drejtën e parablerjes sikurse përcaktohet në paragrafin e mësipërm (në vijim e drejta e parablerjes) duhet të njoftojmë ortakun shitës (në vijim pranim i parablerjes), përmes një njoftimi i cili duhet të dërgohet brenda dhe jo më vonë se 30 ditë pune nga data e marrjes së njoftimit të parablerjes.

Në pranimin e parablerjes duhet të tregohet vullneti i pakushtëzuar për blerjen e të gjitha kuotave të ofruara me të njëjtat kushte për të cilat është rënë dakort në palën blerëse.

Nëse ortakët e tjerë nuk ushtrojnë të drejtën e parablerjes sipas afateve të përcaktuara më lart, ortaku shitës është i lirë që kuotat e ofruara t'ia shesë të tretëve, në përputhje me çmimin, afatet dhe kushtet e përcaktuara në njoftimin e parablerjes, brenda 30 ditëve pune nga mbarimi i afatit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm.

Dispozitat e nenit 9 për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.





**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

---



**KAPITULLI 3**  
**MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE**

**NENI 10**  
**SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

**NENI 11**  
**KUFIZIMET E SHPËRNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE, PËRGJEGJËSITË**

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitim ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- Aktivitetet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj
- Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendeve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund të lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendeve të shpërndarë.



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



#### KAPITULLI 4 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Administratorët

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

##### NENI 12 TË DREJTAT DHE DETYRAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

1. Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;





**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



2. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
3. Investime;
4. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërdrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur djeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të.

### **NENI 13**

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktura nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit për shoqëritë tregëtare.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % përqind të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet në raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

**BT SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



#### **NENI 14**

#### **MËNYRA E THIRRJES**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.  
Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'i dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 15**

#### **KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit për shoqëritë tregëtare.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve që ka bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a. Të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b. T'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët, njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.
4. Përfaqësimi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjera të ndryshme nga të ortakut të përfaqësuar.

BT SOLUTIONS

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



#### **NENI 16**

#### **PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 17**

#### **KUORUMI**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të jashtëzakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 18**

#### **MARRJA E VENDIMEVE**

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në paragrafin (18.4) për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

**BT SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
4. Vendimet e asamblesë së përgjithshme në lidhje si më poshtë, merren vlefshëmrisht me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë:

- Miratimi i bilancit
- Shpërndarja e dividendeve
- Emërimi dhe ose shkarkimi i administratorëve dhe ekspertët kontabël dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre
- Emërimi dhe shkarkimi i personit që do të merret me kontabilitetin e shoqërisë
- Miratimi i buxhetit vjetor
- Autorizimin për nënshkrimin e cfarëdolloj kontrate
- Miratimi i kërkesës për përjashtimin e njërit prej ortakëve
- Ndryshimet e statutit
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit
- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë

#### **NENI 19** **E DREJTA E VOTËS**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a. Transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b. Komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili i mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër
  - c. Mekanizma që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qënë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.



4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'i mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statut, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

#### **NENI 20**

##### **PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku që përfaqëson.

#### **NENI 21**

##### **PROÇESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESE**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së masamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.





**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**NENI 22**  
**HETIMET E POSAÇME**

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që perfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në menyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 viteve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Proçedurës Civile.

**NENI 23**  
**SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TË PARREGULLTA DHE DËMSPËRBLIMI**

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse, shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.





**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 përqind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrejë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.
3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.
4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacënuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.
6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.
7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të këtij ligji zbatohet edhe për padi.

---

BT SOLUTIONS

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: +355 42 374292

Cel: +355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

---

 **KYOCERA**  
Document Solutions

#### **NENI 24**

#### **TË DREJTAT E LIDHURA ME KUOTËN**

1. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

#### **NENI 25**

#### **NDALIMI I KUFIZIMEVE**

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92, 93 të këtij ligji si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cënojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji.

#### **ADMINISTRATORËT**

#### **NENI 26**

#### **EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë sipas përcaktimit të nenit 20 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.  
Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:



- a. Kryejnë të gjitha veprimet të administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
  - b. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
  - c. Kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
  - d. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
  - e. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
  - f. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
  - g. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
  - h. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht asamblenë.
6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është znj. Merita Halla deri më 04.02.2026.

**NENI 28**  
**PËRFAQËSIMI**

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo



- për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 29**  
**SHPËRBLIMI**

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë në përqindje në fitim ose të ngjashëm.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjëndjen financiare të shoqërisë.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

**NENI 30**  
**DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA**

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:
  - a. Të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b. Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
  - c. Të vlerësojnë me vështirësi çështjet, për të cilat merret vendim
  - d. Të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm, të interesave personale me atë të shoqërisë;
  - e. Të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.
  - f. Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**Document Solutions**

gëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mosbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme.
  - a. u kthejnë ortakëve kontributet
  - b. u paguajnë ortakëve interesa apo dividende
  - c. u shpërndajnë aktivet shoqërisë
  - d. lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
  - e. I jepen kredi
5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të ligjit për shoqëritë tregëtare zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

**BT SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)



**Document Solutions**

**KAPITULLI 5**

**PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

**KREU 1**

**PRISHJA E SHOQËRISË**

**NENI 31**

**SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parshikuar në themelimin e saj,
- b. Me vendim të asamblesë së përgjithshme
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e. Me vendim të gjykatës
- f. Dhe për arsye të tjera të parashikuara në statut.

**NENI 32**

**REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES**

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723 datë 3/05/2007: Për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

**KREU 2**

**LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

**NENI 33**

**LARGIMI I ORTAKUT PËR SHKAQE TË NDRYSHME:**

BT SOLUTIONS

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania

Tel: + 355 42 374292

Cel: + 355 68 40 300 28

E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)

Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)





1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.
3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likujdohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likujdimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mbledhet apo njeh të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimet e kuotës.
5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer për shkaqe të paarsyeshme.
6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

**NENI 33**  
**PËRJASHTIMI I ORTAKUT**

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
  - a. me dashje apo pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë
  - b. me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkel statusin ose detyrimet e përcaktuar me ligj
  - c. përfshihet në veprime të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut ose
  - d. me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marr një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera që



**BT  
SOLUTIONS**

Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

**KYOCERA**  
Document Solutions

rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar, shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim, nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkak të ndryshme, por nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për dëmshpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **NENI 34**

#### **PASOJAT E LARGIMIT DHE PËRJASHTIMIT**

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin
2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

#### **NENI 35**

#### **LIKUJDIMI NË GJËNDJE E AFTËSISË PAGUESE**

Në rastet kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

**Tiranë, më 19.06.2021**

#### **ORTAKË I VETËM I SHOQËRISË**

**Z. Kristi BOJDANI**

*Kristi Bojdani*

BT SOLUTIONS  
Rr. "Hoxha Tahsin" 62/5, Tirana, Albania  
Tel: +355 42 374292  
Cel: +355 68 40 300 28  
E-mail: [info@btsolutions.al](mailto:info@btsolutions.al)  
Web: [www.btsolutions.al](http://www.btsolutions.al)

